

Statistikat afatshkurtra

Prodhuesit e të mirave - Tremujori IV 2024


Tiranë, më 18 Mars 2025: Treguesit tremujorë mbi prodhuesit e të mirave, përfshijnë aktivitetet ekonomike: Industri (Industri Nxjerrëse dhe Industri Përpunuese); Energji elektrike, Gaz, Avull; Furnizimi me ujë, Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve; Ndërtim, në tremujorin e katërt 2024, paraqiten si më poshtë:

Industria:

Indekset e treguesve në aktivitetin Industri, në tremujorin e katërt 2024, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 14,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rënie 13,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rënie 6,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 1,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Industri (%)




Energji elektrike, Gaz, Avull:

Indekset e treguesve në aktivitetin Energji elektrike, Gaz, Avull, në tremujorin e katërt 2024, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 0,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rënie 13,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rënie 6,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 4,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig.2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Energji elektrike, Gaz, Avull (%)




Furnizimi me ujë, Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve:

Indekset e treguesve në aktivitetin Furnizimi me ujë dhe Trajtimi e menaxhimi i mbetjeve, në tremujorin e katërt 2024, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 4,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rënie 2,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 1,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 10,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 3 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Furnizimin me ujë, Trajtimi e menaxhimi i mbetjeve (%)




Ndërtimi:

Indekset e treguesve në aktivitetin Ndërtim, në tremujorin e katërt 2024, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 2,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 1,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 1,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 16,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 4 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto, Ndërtim (%)



Tab. 1 Indeksi i shitjeve neto në volum, prodhuesit e të mirave

NVE Rev.2			Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.IV 2024 (2021=100)	IV.24 / IV.23 (%)	Tr.IV 2024 (2021=100)	IV.24 / III.24 (%)
B-C	05-33	Industri	86,5	-14,4	83,1	-5,7
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	62,1	-32,5	57,6	-10,1
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	92,9	-9,8	90,1	-4,2
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	80,1	-0,8	73,1	5,6
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	109,7	-4,4	107,7	-5,4
F	41-43	Ndërtim	160,2	2,7	129,1	9,5
Grupimet industriale kryesore						
		Mallra të ndërmjetme	78,1	-22,3	67,8	-1,3
		Energji	77,0	-3,6	70,3	4,5
		Mallra kapitale	106,4	-0,3	98,1	0,9
		Mallra të qëndrueshme konsumi	97,5	-11,7	84,1	2,1
		Mallra të paqëndrueshme konsumi	103,8	-1,2	100,2	-1,6

Tab. 2 Indeksi i prodhimit në volum, prodhuesit e të mirave

NVE Rev.2			Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.IV 2024 (2021=100)	IV.24 / IV.23 (%)	Tr.IV 2024 (2021=100)	IV.24 / III.24 (%)
B-C	05-33	Industri	89,2	-13,7	83,6	-4,9
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	62,6	-31,9	60,7	-7,7
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	98,7	-7,5	92,6	-2,8
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	107,1	-13,5	93,5	40,1
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	121,7	-2,5	122,0	-6,7
F	41-43	Ndërtim	163,3	1,9	124,8	3,9
Grupimet industriale kryesore						
		Mallra të ndërmjetme	81,6	-23,0	77,0	-4,0
		Energji	89,1	-16,7	73,4	14,8
		Mallra kapitale	106,5	-1,9	99,1	3,0
		Mallra të qëndrueshme konsumi	110,2	-4,9	92,0	7,5
		Mallra të paqëndrueshme konsumi	103,1	-4,4	98,8	0,9

Tab. 3 Indeksi i numrit të të punësuarve dhe fondit të pagave, prodhuesit e të mirave

NVE Rev.2			Numri i të të punësuarve		Fondi i pagave	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.IV 2024 (2021=100)	IV.24 / IV.23 (%)	Tr.IV 2024 (2021=100)	IV.24 / IV.23 (%)
B-C	05-33	Industri	93,9	-6,5	136,4	1,9
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	94,2	-4,3	138,3	5,0
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	93,9	-6,7	136,3	1,6
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	105,0	-6,0	138,0	4,0
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	106,6	1,2	148,5	10,8
F	41-43	Ndërtim	106,8	1,8	159,3	16,9

Metodologjia

Informacion

Në vazhdim të përpjekjeve të përafrimit dhe standardizimit të statistikave afatshkurtra me statistikat evropiane, INSTAT publikon Statistikat Afatshkurtra –Të mira si më poshtë:

- Indekset duke filluar nga tremujori i parë 2024, do të llogariten me vit bazë 2021=100.
- Peshat janë llogaritur bazuar në rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve për vitin reference 2022, realizuar nga INSTAT.

Informacion mbi vrojtimin

Qëllimi - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

Në prodhuesit e të mirave:

Fusha e mbulimit - Bazuar në aktivitetin kryesor, në anketën tremujore pranë ndërmarrjeve janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Industri, e cila përbëhet nga Industria Nxjerrëse dhe Përpunuese (05 – 33)
- Energji elektrike, gaz, avull (35)
- Furnizimi me ujë, trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve (36-39)
- Ndërtim (41, 42, 43)

Modeli - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku kampioni për ndërmarrjet me 1-9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

Mbledhja e informacionit - Për këtë tremujor janë përdorur burimet administrative dhe intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2021=100, Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash, Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres, Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor.

Ndryshimi vjetor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më pare.

Ndryshimi tremujor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

Rishikimi – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur, etj.

Përkufizimet e treguesve kryesorë

Shitjet neto - *Shitjet neto* përfshijnë shumat e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korespondon me tregun e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar.

Indeksi i shitjeve neto - Objektivi i indeksit të *shitjeve neto* është të paraqesë ecurinë e tregut për mallra dhe shërbime.

Numri i të punësuarve me pagesë - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përjashtuar të vetëpunësuarit me pagesë).

Paga dhe trajtime - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërblimet e trajtimit (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese, Indeksi i fondit të pagave - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtuar, nga njëra periudhë në tjetrën.

Grupimet Industriale Kryesore janë një rigrupim i aktiviteteve Industri Nxjerrëse, Industri Përpunuese dhe Energji të detajuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2), si më poshtë:

Grupimet Industriale Kryesore	NVE Rev,2
Mallra të ndërmjetme	<ul style="list-style-type: none"> • 07-09 Nxjerja e mineraleve natyrore; Nxjerja e mineraleve të tjera nga minierat; Aktivitete mbështetëse minerare • 13000 Përpunimi i tekstileve • 16000 Prodhimi i drurit dhe materialeve prej druri, përveç mobiljeve • 17000 Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre • 20-21 Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike; Përpunimi i produkteve farmaceutike • 22000 Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës • 23000 Prodhimi i produkteve minerale jo metalike • 24000 Metalurgjia • 255XX Farkëtimi, stampimi, petëzimi dhe trafilizimi i metaleve • 27000 Prodhimi i pajisjeve elektrike
Energji	<ul style="list-style-type: none"> • 05-06 Nxjerja e qymyrit dhe linjiteve; Nxjerja e naftës bruto dhe gazit natyror • 19000 Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës • 35000 Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri i kondicionuar
Mallra kapitale	<ul style="list-style-type: none"> • 251XX Prodhimi i produkteve metalike strukturore • 262XX Prodhimi i kompjuterave dhe pajisjeve periferike • 28000 Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t

	<ul style="list-style-type: none"> • 33000 Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve
Mallra të qëndrueshme konsumi	<ul style="list-style-type: none"> • 264XX Prodhimi i produkteve elektronike për konsumatorët • 31000 Prodhimi i mobiljeve • 32XXX Industri të tjera p,k,t
Mallra të paqëndrueshme konsumi	<ul style="list-style-type: none"> • 10000 Përpunimi i produkteve ushqimore • 11-12 Prodhimi i pijeve; Prodhimi i produkteve të duhanit • 14000 Konfeksionimi i veshjeve • 15000 Prodhimi i lëkures dhe produkteve prej lëkure • 18000 Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara • 32YYY Industri të tjera p,k,t

Përshtatja sezonale

Përshtatja sezonale në seritë tremujore të prodhimit të të mirave materiale u zbatua duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.2.4. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecifikimin X-13 në serinë kohore Tremujori I 2006 - Tremujori IV 2024. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizshme. Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative). Në metodën multiplikative ekziston një lidhje midis komponentit të trendit, komponentit sezonal dhe komponentit irregular, ku ky i fundit shpjegon ato pjesë të serisë kohore të cilat nuk mund të parashikohen dhe janë të pazakonshme. Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezonale në pasqyrimin e statistikave afatshkurtra. Për përshtatjet sezonale të serive është përdorur qasja direkte. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e veçanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.